



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MAT
KRYETARI**

Nr. _____ Prot.

Burrel, më _____.____.2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Bashkimin e Operatorëve Ekonomik: “ARABEL - STUDIO” Sh.p.k, me numër Nipt-i: **L51812001S**, me seli: *Dibër, Peshkopi, lagjja “Gjokë Doçi”, Bulevardi “Elez Isufi”, Z.K. Nr.2932, Zyra në ndërtesën Nr.05,* dhe **“HMK - Consulting” Sh.p.k.**, me numër Nipt-i: **L57129604Q**, me seli: *Tiranë, rruga “Zef Jubani”, pallati “Bjorn”, sh 3/5, ap. C/1, hyrja 20.*

Procedura e prokurimit: **“Kërkesë për Propozim - Shërbime”**, prokurim elektronik

Numri i referencës së procedurës: **Loti 1: REF-73373-09-29-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Loti Nr. 1: “Mbikqyerje të punimeve për investimin me objekt: “Ndërtim ujësjellësi për furnizimin me ujë i qytetit Burrel, të fshatrave të njësisë administrative Derjan dhe Rukaj –Loti I”, me fond limit në vlerën: 4 490 833 (katër milion e katërqind e nëntëdhjetë mijë e tetëqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH nga buxheti i shtetit, ndarë për vitin 2020 në vlerën: 943 290 (nëntëqind e dyzet e tre mijë e dyqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH, për vitin 2021 - 2023 në vlerën: 3 547 543 (tre milion e pesëqind e dyzet e shtatë mijë e pesëqind e dyzet e tre) lekë pa TVSH, me afat realizimi të shërbimit: 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit (i njëjtë me afatin e realizimit të punimeve nga shoqëria ndërtimore e cila do të zbatojë punimet).**

Publikime të mëparshme: *nuk ka patur*

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 82, datë 05 Tetor 2020

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik: “ARABEL - STUDIO” Sh.p.k, me numër Nipt-i: **L51812001S**, dhe **“HMK - Consulting” Sh.p.k.**, me numër Nipt-i: **L57129604Q**

Vlera: **3 929 479** (tre milion e nëntëqind e njëzet e nëntë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH

2. Operatorin Ekonomik: “ERSI/M” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **J986248030**

Vlera: **4 162 463.29** (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tre pikë njëzet e nëntë) **lekë pa TVSH**

3. Operatorin Ekonomik: “**GJEOKONSULT & CO**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **K91810005U**

Vlera: **3 999 442** (tre milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e dyzet e dy) **lekë pa TVSH**

4. Operatorin Ekonomik: “**INSTITUTI DEKLIADA - ALB**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **K71606006A**

Vlera: **3 929 478.31** (tre milion e nëntëqind e njëzet e nëntë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tetë pikë tridhjetë e një) **lekë pa TVSH**

Janë s’kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatorin Ekonomik: “**ERSI/M**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **J986248030**
2. Operatorin Ekonomik: “**GJEOKONSULT & CO**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **K91810005U**
3. Operatorin Ekonomik: “**INSTITUTI DEKLIADA - ALB**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **K71606006A**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtëm:

- ❖ **Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “ERSI/M” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Pranimit/ Kualifikimit, si më poshtë:**

- I. **Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 1 gërma “b”/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:**

“1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 1/1;”

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, në Deklaratën për paraqitje oferte të pavaruar është klikuar gërma “b)” rasti i bashkimit të operatorëve ekonomik ose nënkontraktimit, kur ofertuesi ka paraqitur dokumentacionin si pjesëmarrës i vetëm në këtë procedurë prokurimi.**

- II. **Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.2.4/ 2.2 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:**

“2.2.4 Vërtetim lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e taksave për vitin 2018 dhe 2019 për adresën ku operatori ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR.”

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në**

dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, në vërtetimin e paraqitur nga bashkia për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore, nuk përcaktohet se për kë vit janë shlyer këto detyrime.

III. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.2/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.1 Liçensa profesionale të shoqërisë për mbikqyerje, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, sipas modelit të lëshuar nga MPPT:

- ***Liçense profesionale e shoqërisë e vlefshme në kategoritë:***
 - ***Kategoria NP-1 (Punime gërmimi në tokë)***
 - ***Kategoria NP-5 (Punime nëntoksore, ura e vepra arti)***
 - ***Kategoria NP-6 b (Diga te vogla)***
 - ***Kategoria NP-7a (Ujësjiellësa, gazsjiellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje)***
 - ***Kategoria NP-12 (Punime të inxhinierisë së mjedidit)***
 - ***Kategoria NS-4 (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, ...)***
 - ***Kategoria NS-8a (Ndërtime parafabrikat beton arme)***
 - ***Kategoria NS-9 (Punime strukturorë speciale)***
 - ***Kategoria NS-16 (Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij)***
 - ***Kategoria NS-18 (Punime topogjeodezike)***

** Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i licensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit në plotësimin e liçensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, Liçencën e shoqërisë “Për Mbikqyerje dhe Kolaudim të Punimeve të zbatimi”, konstatohet se, nuk disponon kategoritë e liçencës NP-6b dhe NS-16.**

IV. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.4 gërma “b”/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

b) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në liçencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha shërbimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë noteriale pune të vlefshme (me kohë të plotë), diplomë, CV, librezat e punës, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën “a”, stafi inxhinierik si më poshtë:

- ***Minimuni 2 (dy) Inxhinier Ndërtimi***
- ***Minimuni 1 (një) Inxhinier Hidroteknik***
- ***Minimuni 1 (një) Inxhinier Gjeolog***
- ***Minimuni 1 (një) Inxhinier Mjedis***
- ***Minimuni 2 (dy) Inxhinier Topograf***

- *Minimumi 1 (një) Inxhinier Mekanik*

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se:**
 - Nuk disponon minimumi 1 (një) inxhinier Mjedisi;
 - Nuk janë paraqitur librezat e punës të inxhinierëve pjesë të stafit teknik si dhe CV e paraqitura janë të pafirmosur nga ana e tyre;
 - Nuk përmbushet kushti për disponimin minimumi 2 (dy) inxhinier Topograf, pasi: Për inxhinierin Gjeodet (SH.M) i cili figuron në listëpagesat e shoqërisë nuk është paraqitur kontrata noteriale e punës, ndërsa 2 inxhinierat e tjerë, inxhinierin Gjeodet (R.N) nuk keni paraqitur: Kontratë Noteriale Pune, Diplomë, Librezë pune si dhe CV është e pafirmosur, ndërsa për inxhinierin Topograf (XH.R) nuk është paraqitur Diploma, Libreza e punës si dhe CV e tij;
 - Për inxhinieren Hidroteknike që keni paraqitur diplomë dhe kontratën e punës, rezulton se nuk figuron në listëpagesë, në asnjë nga muajt e periudhës së kërkuar, ndërsa për inxhinieren tjetër nuk keni paraqitur kontratën noteriale të punës, Librezë pune dhe CV.

V. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.4 gërma “c”/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

- c) *Kandidati ofertues duhet të ketë pjesë të stafit një inxhinier i çertifikuar si “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj Emergjencave”, të vërtetuar me kontratë noteriale pune të vlefshme (me kohë të plotë), diplomë, Çertifikatë, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën “a”.*
- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk disponon një inxhinier të çertifikuar si “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj Emergjencave”.**

VI. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.4 gërma “d”/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

- d) *Kandidati ofertues duhet të ketë pjesë të stafit një inxhinier mjedisi të çertifikuar si “Përgjegjës për mbrojtjen dhe menaxhimin e dëmeve në mjedis”, të vërtetuar me kontratë noteriale pune të vlefshme (me kohë të plotë), diplomë, Çertifikatë, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën “a”.*
- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk disponon një inxhinier mjedisi të çertifikuar si “Përgjegjës për mbrojtjen dhe menaxhimin e dëmeve në mjedis”.**

VII. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.4 gërma “e”/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

- e) *Kandidati ofertues duhet të jete i pajisur me Licence Kodi III.7.A “Për Shërbime të ekspertizës dhe profesionale lidhur me burimet mjedisore bazë” të vërtetuar me kontratë noteriale pune të*

vlefshme (me kohë të plotë), diplomë, Çertifikatë, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën “a”.

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk disponon Licencë Kodi III.7.A “Për Shërbime të ekspertizës dhe profesionale lidhur me burimet mjedisore bazë”.

VIII. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.5/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.5 (Makineri, Pajisje)

- a) Operatori ekonomik duhet të paraqesë automjetet dhe pajisjet (sipas tabelës) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;

Nr.	Përshkrimi i Automjetit/ Pajisjes	Sasia
1.	Automjet	jo më pak se 1 copë
2.	Pajisje GPS	jo më pak se 1 copë

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi nuk është paraqitur asnjë dokumentacion për vërtetimin e disponimit të 1 (një) automjeti dhe 1 (një) pajisje GPS.

IX. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.6/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/ Kualifikimit:

“2.3.6 Operatori Ekonomik krahas Formularit të Ofertës, duhet të paraqesë dhe Analizën e përlllogaritjes së ofertës, në respektim të Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.354, datë 11.05.2016 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikqyerje dhe Kolaudim” si dhe shkresës Nr.Prot.5585, datë 25.07.2017 “Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikqyerje dhe Kolaudim” Mosdorëzimi i Formularit të Ofertës së bashku me analizën e përlllogaritjes sipas përcaktimeve të VKM-së Nr.354, datë 11.05.2016, është kusht për s’kualifikim.”

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk ka paraqitur analizën e përlllogaritjes sipas përcaktimeve të VKM-së Nr.354, datë 11.05.2016, e cila përbën kusht për s’kualifikim.

- ❖ Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “Gjeokonsult & Co” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë

dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Pranimit/ Kualifikimit, si më poshtë:

I. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.4 gërma “d”/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

d) Kandidati ofertues duhet të ketë pjesë të stafit një inxhinier mjedisi të çertifikuar si “Përgjegjës për mbrojtjen dhe menaxhimin e dëmeve në mjedis”, të vërtetuar me kontratë noteriale pune të vlefshme (me kohë të plotë), diplomë, Çertifikatë, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën “a”.

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, inxhinier i çertifikuar si “Përgjegjës për mbrojtjen dhe menaxhimin e dëmeve në mjedis” nuk është inxhinier mjedisi.**

II. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.4 gërma “e”/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

e) Kandidati ofertues duhet të jete i pajisur me Licence Kodi III.7.A “Për Shërbime të ekspertizës dhe profesionale lidhur me burimet mjedisore bazë” të vërtetuar me kontratë noteriale pune të vlefshme (me kohë të plotë), diplomë, Çertifikatë, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën “a”.

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk disponon Licencë Kodi III.7.A “Për Shërbime të ekspertizës dhe profesionale lidhur me burimet mjedisore bazë”.**

III. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.6/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/ Kualifikimit:

“2.3.6 Operatori Ekonomik krahas Formularit të Ofertës, duhet të paraqesë dhe Analizën e përllogaritjes së ofertës, në respektim të Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.354, datë 11.05.2016 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikqyerje dhe Kolaudim” si dhe shkresës Nr.Prot.5585, datë 25.07.2017 “Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikqyerje dhe Kolaudim” Mosdorëzimi i Formularit të Ofertës së bashku me analizën e përllogaritjes sipas përcaktimeve të VKM-së Nr.354, datë 11.05.2016, është kusht për s’kualifikim.”

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, analiza e çmimit nuk është përllogaritur sipas përcaktimeve të VKM-së Nr.354, datë 11.05.2016, e cila përbën kusht për s’kualifikim.**

❖ **Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “Instituti Dekliada-Alb” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Pranimit/ Kualifikimit, si më poshtë:**

I. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.4 gërma “a”/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

*2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesi **dëshmi nga administrata tatimore (Drejtoria Rajonale e tatim taksave)** për punësimin mesatar jo më pak se **6 (gjashtë) punonjës** për periudhën **Gusht 2019 – Gusht 2020**,*

a) Të paraqiten:

- 1. Një vërtetim nga administrata tatimore për numrin mesatar të punonjësve për periudhën **Gusht 2019 – Gusht 2020***
 - 2. Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore për periudhën **Gusht 2019 – Gusht 2020**.*
- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk janë paraqitur Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore për periudhën, muajt: Janar 2020 dhe Shkurt 2020;**

II. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.4 gërma “b”/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

b) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në licencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha shërbimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë noteriale pune të vlefshme (me kohë të plotë), diplomë, CV, librezat e punës, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën “a”, stafi inxhinierik si më poshtë:

- *Minimuni 2 (dy) **Inxhinier Ndërtimi***
 - *Minimuni 1 (një) **Inxhinier Hidroteknik***
 - *Minimuni 1 (një) **Inxhinier Gjeolog***
 - *Minimuni 1 (një) **Inxhinier Mjedisi***
 - *Minimuni 2 (dy) **Inxhinier Topograf***
 - *Minimuni 1 (një) **Inxhinier Mekanik***
- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk disponon minimumi 2 (dy) Inxhinier Topograf, por vetëm një të tillë;**

III. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.4 gërma “e”/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

*e) Kandidati ofertues duhet të jete i pajisur me **Licence Kodi III.7.A “Për Shërbime të ekspertizës dhe profesionale lidhur me burimet mjedisore bazë”** të vërtetuar me kontratë noteriale pune të*

vlefshme (me kohë të plotë), diplomë, Çertifikatë, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën “a”.

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk disponon Licencë Kodi III.7.A “Për Shërbime të ekspertizës dhe profesionale lidhur me burimet mjedisore bazë”.

IV. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.6/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/ Kualifikimit:

“2.3.6 Operatori Ekonomik krahas Formularit të Ofertës, duhet të paraqesë dhe Analizën e përlllogaritjes së ofertës, në respektim të Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.354, datë 11.05.2016 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikqyerje dhe Kolaudim” si dhe shkresës Nr.Prot.5585, datë 25.07.2017 “Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikqyerje dhe Kolaudim” **Mosdorëzimi i Formularit të Ofertës së bashku me analizën e përlllogaritjes sipas përcaktimeve të VKM-së Nr.354, datë 11.05.2016, është kusht për s’kualifikim.**”

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk ka paraqitur analizën e përlllogaritjes sipas përcaktimeve të VKM-së Nr.354, datë 11.05.2016, e cila përbën kusht për s’kualifikim.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Informojmë **Bashkimin e Operatorëve Ekonomik: “ARABEL - STUDIO”** Sh.p.k, me seli: Dibër, Peshkopi, lagjja “Gjokë Doçi”, Bulevardi “Elez Isufi”, Z.K. Nr.2932, Zyra në ndërtesën Nr.05, me numër Nipt-i: **L51812001S**, dhe **“HMK - Consulting”** Sh.p.k., me seli: Tiranë, rruga “Zef Jubani”, pallati “Bjorn”, sh 3/5, ap. C/1, hyrja 20, me numër Nipt-i: **L57129604Q**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej: **3 929 479** (tre milion e nëntëqind e njëzet e nëntë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e nëntë) **lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkisë Mat** (Sektori Juridik dhe Prokurimeve Publike) me adresë: Sheshi “Ahmet Zogu”, Nr.1, KP 8001, Burrel, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **5 (pesë) ditëve** nga dita e marrjes/ publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe do të procedohet konform dispozitave ligjore në fuqi të parashikuara nga Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: **20.10.2020**

Ankesa: **Nuk ka patur.**

Titullari i Autoritetit Kontraktor